



"Rruga më e mirë për të dalë nga një vështirësi është ta përballosh dhe drejtpërdrejt".

Anonime



"Çfarë mbetet pas nesh apo e kemi përpara, janë të papërfillshme në krahasim me atë që gjendet brenda nesh."

Ralph Waldo Emerson



ADRESA E ZYRËS:

Programi i Ndërhyrjes në Familje
(Family Intervention Program (FIP))
Family Safety Center (Qendra e Sigurisë Familjare)
610 Murfreesboro Pike
Nashville TN 37210



Programi i Ndërhyrjes në Familje (PNF) ndodhet në Family Safety Center (Qendrën e Sigurisë Familjare). Kur të mbërrini, kontrolloni me shërbimin e sigurimit.



Për një takim telefononi
(615) 862-7773

Ky projekt u mbështet nga Çmimi Nr. 2017-VA-GX-0051, dhënë nga Zyra për Viktimat e Krimit, Zyra e Programeve të Drejtësisë, Departamenti i Drejtësisë i USA, përmes Zyrës së Programeve të Drejtësisë Penale të Tennessee.

Albanian

DUKE SJELLË SËRISH JETË SË BASHKU



KUR JU OSE DIKUSH QË NJIHNI, PREKET NGA KRIMI

Sa herë që ndodh një krim, preken shumë njerëz – viktima, anëtarë të familjes, miq dhe madje, një komunitet i tërë. Askush nuk është i/e përgatitur për pasojat fizike dhe emocionale të krimit, që mund të jenë shkatërruese, si për ata që janë dëmtuar, ashtu edhe për familjet dhe miqtë e tyre. Motivuar nga vuajtjet reale të njerëzve, jetët e të cilëve janë prekur nga krimi, Departamenti i Policisë së Nashville (Metro Nashville Police Department (MNP)) ka mundësuar këshillim, mbrojtje dhe shërbime mbështetëse për viktimat e krimit dhe persona të tjerë, jetët e të cilëve janë prekur nga krimi i dhunshëm, kjo që prej vitit 1975.

NDIHMA ËSHTË KËTU

Në vitin 2016, dy programe këshillimi dhe advokimi të MNP-së, Programi i Ndërhyrjes së Viktimave (VIP) dhe Këshillimi për Dhunën në Familje, u bashkuan për t'u bërë Programi i Ndërhyrjes në Familje (FIP). Këto shërbime u ngritën mbi idenë se kujtdo, që përjeton trauma si rrjedhojë e një akti kriminal, duhet t'i ofrohet shërbime ndërhyrjeje në raste krizash, si edhe ndjekje pa pagesë dhe e menjëhershme. Me staf nga profesionistë të licencuar të shëndetit mendor dhe avokatë/e të kualifikuar/a, FIP është e përkushtuar të ndihmojë këdo që është prekur nga dhuna, për të gjetur dhe rivendosur një ndjenjë paqeje dhe ekuilibri në jetën e tyre. Vendimi i viktimës për ndjekjen penale nuk ndikon në të drejtën për t'u përzgjedhur.

Misioni i FIP është të ofrojë shërbime të shëndetit mendor dhe mbrojtje të sistemit të drejtësisë penale sa herë që individët, familjet dhe/ose komuniteti preken nga krimi i dhunshëm. Të gjitha shërbimet janë falas, konfidenciale dhe ofrohen në një mjedis që mbështet diversitetin kulturor: në lidhje me racën, fenë, besimin dhe orientimin seksual.



NJË GAMË E GJERË SHËRBIMESH

Një staf empatik dhe i përgjegjshëm kulturalisht ofron:

NDËRHYRJE NË RASTE KRIZASH

Një përgjigje 24 orë në 24, për viktimat dhe qytetarët, e drejtuar nga oficeri/ët përgjegjës, kur raportohet një krim.

KËSHILLIM

Shërbimet e këshillimit profesional për individët, anëtarët e familjes dhe të tjerë të prekur nga krimi. Grupet mbështetëse për popullata të ndryshme viktimat/të mbijetuar ofrohen gjatë gjithë vitit.

REAGIME NDAJ KRIZAVE NË GRUP

Ndërhyrje krizash në grup ofrohen sipas kërkesës, kur bizneset, shkollat ose grupet e tjera preken nga dhuna.

ADVOKIM & MENAXHIMI RASTEVE

Udhëzime, mbështetje dhe sqarime përgjatë procedurave policore dhe gjyqësore. Ndhma është e disponueshme për sigurimin e nevojave bazë dhe kërkesën e Kompensimit për Dëmtim Penal të TN.

SHËRBIME TË SPECIALIZUARA

Advokim i përgjegjshëm kulturor/punë në terren për popullsinë diverse të Nashville, duke përfshirë specialistë/e për refugjatë/e dhe emigrantë/e, staf dygjuhësh, informacion në shumë gjuhë dhe disponueshmëri për përkthyes/e kur nevojitet.

KONSULTIM DHE TRAJNIM

Prezantime të disponueshme për grupet e komunitetit dhe profesionistët, për të rritur ndërgjegjësimin dhe kuptimin e shërbimeve FIP, efektet e traumës/viktimizimit; si edhe ndërgjegjësimi dhe reagimi kulturor për popullatat specifike të viktimave.

INFORMACION DHE REFERIME

Koordinim me ofruesit e kujdesit shëndetësor, shërbimet sociale dhe sistemin e drejtësisë penale.

ËSHTË ZGJEDHJA JUAJ

Qëllimi kryesor i Programit të Ndërhyrjes Familjare është të ndihmojë individët dhe familjarët e tyre të rifitojnë një ndjenjë shëndeti dhe mirëqenieje pas një krize. Nëse ju ose dikush që njihni është viktimë e një krimi, ju lutemi telefononi numrin e duhur të renditur më poshtë.

Programit të Ndërhyrjes Familjare (615) 862-7773

NUMRA TË TJERË KONTAKTI

Investigime Policore:

North Precinct (Zona e Veriut)	(615) 862-7901
South Precinct (Zona e Jugut)	(615) 862-7763
East Precinct (Zona e Lindjes)	(615) 862-7525
West Precinct (Zona e Perëndimit)	(615) 862-7385
Zona e Midtown Hills	(615) 880-1513
Zona e Hermitage	(615) 862-6993
Zona e Madison	(615) 880-3311
Central Precinct (Zona Qendrore)	(615) 862-7044
Sex Crimes Unit (Njësia e Krimeve Seksuale)	(615) 862-7540
Domestic Violence Division (Divizioni i Dhunës në Familje)	(615) 880-3000
Zyra e Prokurorisë së Rrethit	(615) 862-5500
TN Criminal Injury Compensation (Kompensime për Dëmtime Penale TN)	(615) 741-2734

REFEROJUNI PANELIT TË PASMË PËR HARTËN DHE ADRESAT.

